

AKT -THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"BASHKIMI" SHPK.



me qytetin e Tiranës sot me date 6.2.1995 formohet shoqëria me per  
gjegjesi te kufizuar "BASHKIMI" SHPK e perbere nga ortakja e vetme Valenti  
na Maletaj, e bija e Gjinit, e datelindjes 1968, banuese ne Pukë, e cila eshte  
bazuar ne kete akt themelimi bie dakord si me poshte:

NENI 1

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- =Ndertimi i objekteve te ndryshme sipas specifikes se tyre.
- =Riparimi dhe meremetimi i objekteve ne perputhje me kerkesat.
- =Prerje, transport, shfrytezim dhe perpunim i lendes drusore, shitje  
e saj brenda dhe jashte vendit, me shumice e pakice.
- =Grumbullim bimesh medicinale, esencave etero-vajore, shitja dhe  
blerja e tyre me shumice e pakice, brenda dhe jashte vendit.
- =Shitja dhe blerja e mallrave te ndryshme industriale, elektrosht  
piake, si dhe mallra ushqimore, brenda dhe jashte vendit, me shumice e pakice
- =Veprimtari tregtare ne fushen e ushqimit social.
- =Veprimtari te ndryshme ne transportin e udhetareve e te mallrave  
ne qytete e porte, pika kufitare, jashte vendit, sipas kerkeses dhe ofertes, q  
do te nevojiten per funksionimin normal te kesaj shoqerie.
- =Importe dhe eksporte te makinerive dhe pajisjeve te ndryshme, p  
seve te kembimit per to, si dhe lendeve te para e materialeve te ndryshme.
- =Operacione tregtare e komisionere.
- =Si dhe qdo aktivitet tjeter qe vegmas ose se bashka me te lert  
permendurit konsiderohet i pershtatshem e me leverdi per shoqerine.

NENI 2

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100000 leke, vlefte e  
likuiduar dhe depozituar nga ortakja e vetme Valentina Maletaj .

NENI 3

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar do te quhet "BASHKIMI" SHPK  
Shoqeria do te fitoje personalitetin e saj juridik, nga dita e regjistrimit  
te saj ne regjistrin e Gjykates se Rrethit Tirane .

NENI 4

Shoqeria do ta kete qendren e saj ne qytetin e Pukes.  
Shoqeria ka te drejte te hape filiale apo dege te tjera ne q  
tete te tjera te Shqiperise.

NENI 5

Shoqeria do ta kete aktivitetin e saj per nje kohe mbi 15 v

NENI 6

Administratore e shoqerise do te jete Valentina Maletaj, or  
ke e vetme.

*V. Maletaj*

NENI 7

Ortaku i vetem ne baze te nenit 37 te ligjit Nr.7637 date 19.11.1992, per kompetencat e asamblese se ortakeve.

NENI 8

Shoqeria tregtare "BASHKIMI" SHPK eshte nje shoqeri private me kapital vendas, e cila do te respektoje te gjitha rregullat dhe vendimet e kene pas koheshme qe do te dalin.

NENI 9

Fitimi i realizuar nga veprimtaria e Shoqerise, merret nga ortak i vetem, sepse dhe kontributi ne kapitalin themeltar eshte vetem i tij.

NENI 10.

Ortaku i vetem ka per detyre te zbatoje te gjitha ligjet me rigorozitet, si dhe te gjitha kushtet e kesaj kontrate.

NENI 11

Ortaku mund te terhijet, dhe te prishe shoqerine, mbasi te kete shlyer te gjitha detyrimet qe ka patur ne zyren e tatimeve apo ato financiare, detyrime te cilat rrjedhin nga veprimtaria e shoqerise.

NENI 12

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin nga marrredheniet e shoqerise me te tretet, dhe me personat e tjere fizike apo juridike do te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert do ti zgjidhin ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

ORTAKI I VETEM

Valentina Maletaj

*V. Maletaj*

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E DREJTESISE

NOTERIA

NR. 640 REP.

NR. 259 KOL.

V E R T E T I M

Sot me daten 7.2.1995 para meje noteres u paraqit personalish ortakja e vetme Valentina Maletaj, me banim ne Puke, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e saj u sigurova nga leter njoftimi qe ajo mban, e cila me deklarroje se eshte dakord sa me siper dhe e neneshkroj ate rregullisht, dhe une noteria e vertetova sipas ligji



NOTERE  
Pranvera Karafili



# STATUTI

## SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "BASHKIMI" SH.P.K.



### 1. HYRJJE:

- 1.1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "BASHKIMI" Shpk, krijohet mbi bazën e iniciativës së lirë dhe kapitalit të ortakës së vetme: Valentina Maletaj, e bija e Gjinit, e datlindjes 1968, banuese në Pukë.
- 1.2. Shoqëria krijohet dhe zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me të gjitha normat e këtij statuti, si dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
- 1.3. Kjo shoqëri Shpk i përballon humbjet e saj deri në kufirin e vleftës së kapitalit themeltar.

### 2. OBJEKTI:

- 2.1. Objekti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Bashkimi" do të jetë:
  - Ndërtimi i objekteve të ndryshme sipas specifikës së tyre.
  - Riparimi dhe meremetimi i objekteve në përputhje me kërkesat.
  - Prerje, transport, shfrytëzim dhe përpunim i lëndës drusore; shitje e saj brënda dhe jashtë vëndit, me shumicë e pakicë.
  - Grumbullim bimësh medicinale, esencave etero-vajore, shitja dhe blerja e tyre me shumicë e pakicë, brënda dhe jashtë vëndit.
  - Shitja dhe blerja e mallrave të ndryshme industriale, elektroshtëpiake, dhe mallra ushqimore, brënda dhe jashtë vëndit, me shumicë e me pakicë.
  - Veprimtari tregëtare në fushën e ushqimit social.
  - Veprimtari të ndryshme në transportin e udhëtarëve e të mallrave në qytete e porte, pika kufitare, jashtë vëndit, sipas kërkesës dhe ofertës, që të nevoiten për funksionimin normal të kësaj shoqërie.
  - Impotre dhe eksporte të paisjeve dhe makinerive të ndryshme, pjesëve të këmbimit për to, si dhe lëndëve të para e materialeve të ndryshme.
  - Operacione tregëtare e komisionere.
  - Si dhe çdo aktivitet tjetër që veçmas ose së bashku me të lartpërmendur konsiderohet i përshtatshëm e me leverdi për shoqërinë.

### 3. EMËRI, TERRITORI, SELIA:

- 3.1. Kjo shoqëri do të quhet "BASHKIMI" SHPK.  
Shoqëria do të krijojë personalitetin e saj juridik, nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregëtar të Gjykatës së rrethit Tiranë.
- 3.2. Shoqëria do të ketë qendrën e saj në qytetin e Pukës.
- 3.3. Shoqëria do të kryejë aktivitetet në të gjithë territorin e Republikës Shqipërisë. Ajo mund të krijojë degë apo përfaqësi në qytete të tjera vëndit.

4. KAPITALI THEMELTAR:

4.1. Kapitali themeltar ishhoqërisë do të jetë në vlerën 100.000 lekë, i

cili është kontribut i ortakess së vetme.

4.2. Ky kapital është likujduar dhe depozituar nga ortakja e vetme.

4.3. Kapitali themeltar mund të lihet peng në përputhje me dispozitat ligjore

4.4. Kapitali themeltar do të depozitohet në njërin prej bankave të Shqipërisë para krijimit të shoqërisë dhe fillimit të veprimtarisë së saj.

4.5. Kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet, sepse ky kapital është minimal i parashikuar nga ligja; por ky kapital mund të shtohet në vartësi të rezultateve dhe të nevojave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4.6. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rrugë trashëgimie

5. FONDET E SHOQËRISË:

5.1. Shoqëria përcakton fondet si më poshtë:

-Fondi Themelor (Qarkullues).

-Fondi Rezervë.

-Fonde të tjera, të cilat mund të jenë të nevojshme gjatë veprimtarisë së shoqërisë.

5.2. Masa e secilit fond dhe mënyra e përdorimit të tij përcaktohet me vendim të organit drejtues të shoqërisë.

6. ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË:

6.1. Organi më i lartë administrativ i shoqërisë do të jetë Asambleja e ortakëve, atributet e së cilës i ka ortakja e vetme.

6.2. Asambleja e Ortakëve ka të drejtë të vendosë për të gjitha çështjet shoqërisë.

6.3. Mbledhja e Asamblesë së ortakëve e zakonëshme dhe jo e zakonëshme do të mbledhet në seksion të zakonshëm dhe jo të zakonshëm, gjithmonë me kërkesë të ortakut, kërkesa do të drejtohet gjithmonë me shkrim administratorës së shoqërisë ose zëvendësit të saj.

6.4. Për çdo mbledhje të Asamblesë së Ortakëve, ortakët do të njoftohen 15 ditë më parë nga administratori me anë të një letre rekomande, e cila duhet të përmbajë seksionin ku do të zhvillohet mbledhja, vendin, datën dhe subjektin e mbledhjes.

6.5. Kompetencat e administratorit të shoqërisë përveç përgatitjes së mbledhjes së ortakëve do të jenë dhe dhënia e autorizimeve të ndryshme sonave të tjerë, për të ndjekur problemet e shoqërisë.

6.6. Administratori i shoqërisë do të ketë të drejtën të ndjekë të gjitha problemet financiare të shoqërisë, të lidhë kontrata me të tretët e

6.7. Në qoftë se administratori i tejkalon kompetencat e dhëna nga Shoqëria në marrdhënie me të tretët, për ato kompetenca të cilat nuk janë në aktin e emërimit, Shoqëria nuk mban përgjegjësi dhe nuk i merr përgjegjësi.

*V. M. ...*

- 6.8. Kompetencat e administratorit mund të caktohen në aktin e emërimit të tij ose në Statutin e Shoqërisë.
- 6.9. Shoqëria do të ketë si administratore ortaken e vetme Valentina Maletaj.



**7. KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË ORTAKËVE:**

- 7.1. Vendos për ndryshimet që mund të bëhen Statutit të shoqërisë, si dhe miraton Rregulloren e shoqërisë dhe të sektorëve të veçantë të saj.
- 7.2. Vendos për politikën afariste të shoqërisë, përcakton fushat konkrete të veprimitarisë së shoqërisë.
- 7.3. Shqyrton bilancin vjetor të shoqërisë, kuotat, fondet e ndryshme, si dhe fitimin e realizuar.
- 7.4. Emëron dhe shkarkon administrtorin e mundëshëm të shoqërisë.
- 7.5. Vendos për degët e shoqërisë si brënda dhe jashtë vëndit.
- 7.6. Vendos për marrjen e kredive, si dhe për mbarimin e shoqërisë.
- 7.7. Vendos për shndërimin e saj në Shoqëri të llojeve të tjera.
- 7.8. Miraton dhe realizon marrdhëniet e shoqërisë me persona të tjerë fizikë apo juridikë.
- 7.9. Vendos për pagat e punonjësve të punësuar në shoqëri.
- 7.10. Emëron një ose disa ekspertë kontabël për të shqyrtuar bilancin vjetor të ardhurat e qarkulluara, si dhe mënyrën e mbajtjes së Rregjistrit të gëtar e të veprimeve kontabël.

**8. NDARJA E FITIMIT:**

- 8.1. Pas përballimit të detyrimeve, taksave, tatimeve, shpenzimeve të ndryshme ortakes së vetme i mbetet në dispozicion fitimi neto.
- 8.2. Fitimi neto mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit të shoqërisë, për shtimin e kapitalit themeltar në natyrë etj.

**9. KOHËZGJATJA E SHOQËRISË:**

- 9.1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "BASHKIMI" SHPK krijohet me një afat mbi 15 vjet.

**10. MBARIMI I SHOQËRISË:**

- 10.1. Veprimtaria e shoqërisë mbaron me vendimin e organit drejtues të saj rast se veprimtaria nuk rezulton fitimprurëse, për shkaqe të forcës mallor si dhe për shkaqe të tjera ligjore.
- 10.2. Shoqëria mund të mbarojë me anë të thithjes ose të bashkimit.

**11. MARRDHËNIET E PUNËSIMIT:**

- 11.1. Çdo person i punësuar konsiderohet si i tillë në bazë të kontratës së punës, të lidhur midis tij dhe shoqërisë, në përputhje me të gjitha detyrat ligjore të punës në fuqi.
- 11.2. Çdo person i punësuar në shoqëri është përgjegjës për kryerjen e detyrës së tij.

*V. Maletaj*

12. DISPOZITAT E FUNDIT:

- 12.1. Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, personave juridikë apo fizikë, si dhe me punonjësit e punësuar në këtë shoqëri, do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërtën do të drejtohen për zgjidhje gjykatës.
- 12.2. Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.
- 12.3. Shoqëria pasurinë e saj mund ta sigurojë në Institutin e Sigurimeve të Republikës së Shqipërisë.
- 12.4. Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësia e saj përcaktohen nga Asambleja e Ortakëve.

Ky Statut u përpilua sot më datë 06.02.1995.

Ortake e vetme  
Valentina Maletaj

*V. Maletaj*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
N O T E R I A

NR. 640 REP  
NR. 259 KOL

V È R T E T I M

Sot më datë 06.02.1995 përpara meje noteres, u paraqit personalisht Valentina Maletaj, ortake e vetme, e bija e bija e Gjinit, e datlindjes 1968, banuese në Pukë, për identitetin e së cilës u sigurova nga letërnjoftimi që mbante, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar e cila më deklaroi se është dakort me sa më sipër dhe e nënshkruan atë rregullisht, dhe unë notere e vërtetova sipas ligjit.

N O T E R E  
Pranvera Karafili

*Pranvera Karafili*

